



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE  
DHE EKONOMISË

13404  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 210 \_\_\_/\_\_\_/2017

**URDHËR**

Nr. 1011, Datë 2 /10/2017

**PËR**

**LEHTËSIMIN E KËRKESAVE DOKUMENTARE TË SHËRBIMEVE TË OFRUARA  
NDAJ BIZNESIT DHE QYTETARËVE NGA MINISTRIA E FINANCEVE DHE  
EKONOMISË DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave,

**U R D H Ë R O J:**

1. Të gjitha strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e saj të varësisë, për çdo shërbim të ofruar ndaj qytetarëve dhe/ose sipërmarrjes, nuk do të kërkojnë më dorëzimin prej tyre të dokumenteve të mëposhtëm:
  - a. Çertifikata e regjistrimit në QKB, përfshirë NIPT/NUIS
  - b. Ekstrakt historik i kompanisë
  - c. Vërtetim për posedim mjetesh
  - d. Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesit E-SIG 02a
  - e. Vërtetim për të ardhurat e realizuara në tre vitet e fundi për tender
  - f. Vërtetim për individ të peregjistruar
  - g. Formulari E-SIG03a Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për individët
  - h. Vërtetim për përgjegjësinë tatimore
  - i. Vërtetim për pagimin e detyrimeve
  - j. Vërtetim për statusin e tatimpaguesit
  - k. Vërtetim për regjistrimin e investitorit tek Drejtoria Rajonale
  - l. Dëshmi penaliteti dhe vërtetim i gjendjes gjyqësore
  - m. Të gjitha llojet e çertifikatave që gjenerohen nga sistemi i gjendjes civile

2. Këto dokumente do të gjenerohen nga strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e saj të varësisë nga portali e-Albania.
3. Të gjitha strukturat e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë dhe institucionet e saj të varësisë të njoftojnë për çdo vështirësi në zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohen të gjitha strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e saj të varësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



**MINISTËR**

**Arben Ahmetaj**